



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE

MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja Solemne e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 17.02.2026, në ora 10:00h, në Hollin e Gjinnazit 'Hivzi Sulejmani' në Fushë-Kosovë.

Prezentë ish-in: Valon Prebreza - Kryetar i Komunës, Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit të Komunës, Drejtorët e Drejtorateve të Komunës, Kryetarët e Komunës Naser Grajcevcu dhe Skënder Zogaj, përfaqësues të Shoqatave të dalura nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfaqëse të Policisë, musafirë të tjerë të ftuar - përfaqësues të familjarëve të cilët janë kontribues për Shtëpitë/Shkolla në vitet e nëntëdhjeta në Komunën e Fushë-Kosovës dhe qytetarë të Komunës së Fushë-Kosovës.

REND DITE

1. Mbledhja solemne për nderë të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
 - Fjala e rastit e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Udhëheqësve të Grupeve Parlamentare në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës.
 - Fjala e rastit e Kryetarit të Komunës së Fushë-Kosovës.
 - Fjala e rastit e përfaqësuesit të Organizatave të dalura të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
2. Ndarja e mirënjohjeve nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës për kontribuesit e Shtëpive/Shkolla në vitet e nëntëdhjeta në Komunën e Fushë-Kosovës.

Rinesa Simnica: Falënderojmë Florent Boshnjakun, për një interpretim të jashtëzakonshëm të Intonimit të Himnit Shtetërorë të Kosovës, si dhe falënderojmë Korin e Gjinnazit 'Hivzi Sulejmani', për interpretimin po ashtu të jashtëzakonshëm të himnit shtetëror dhe të atij kombëtar. Të nderuar të pranishëm përshëndetje mire se po takohemi dhe urime 18 Vjetori i Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Unë kam nderin dhe kënaqësinë, që të ftoj para jush për t'i dhënë fjalën Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës, z. Vlonjat Hasani.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, këtë herë po e mbajmë dhe po e hapim një mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës, kjo formë është pak më ndryshe, por është brenda kornizave procedurale të mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të Komunës, unë zyrtarisht po e shpalli të hapur mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës, kam kënaqësinë që të ju njoftoj për pikat e rendit të ditës të cilat janë, një është 18 Vjetori i Pavarësisë së Kosovës dhe sipas procedurave dhe programit, fjalimet do të mbahen nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës z. Valon Prebreza, pastaj janë Shefat e Grupeve Parlamentare, të tri subjekteve më të mëdha politike, Lëvizjes Vetëvendosje, Lidhjes

Demokratike të Kosovës dhe Partisë Demokratike të Kosovës, pastaj kemi fjalën e rastit nga përfaqësuesit e Organizatave të Dalura nga Lufta, e në fund pas një pauze të shkurtër për arsye të programit artistik, që është interpretim i një monologu, vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, që është shpërndarja e mirënjohjeve për familjet, të cilat kanë dhënë kontributin e tyre gjatë luftës për Shtëpitë-Shkolla në vendin tonë. Po fillojmë me fjalimin e pare, që pastaj t'i lëjmë hapësirë edhe Kryetarit të Komunës dhe të tjerëve në vazhdim. Të nderuar të pranishëm, përfaqësues të Organizatave të Dalura nga Lufta, Familjeve të Dëshmorëve, Policisë së Kosovës, Bashkësisë Islame të Kosovës, Shoqëria Civile dhe Media, i nderuar kryetar Valon Prebreza, të nderuar/a asambleist/e dhe ju të gjithë të tjerë të pranishëm zonja dhe zotërinj, përveç që është nder i madh për mua të jem para jush për këtë fjalim për shënimin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës, është emocion dhe moment krenarie, sot po festojmë 18 vjetorin e shtetit tone - Shpalljen e Pavarësisë, festë kjo e arritur e ndërtuar dhe e fuqizuar nga thirrja, nga aktiviteti, nga lufta e amaneti i dëshmorëve, martirëve, luftëtarëve, të burgosurve dhe popullit tonë në përgjithësi. Kjo është vlera e lirisë, është çmimi i paguar nga populli jonë, andaj me krenari e festojmë këtë ditë 18 Vjetorin e Pavarësisë, janë ata burra dhe gra të vendit të historisë që këmbëngulën për të drejtën tonë të madhe Lirinë, janë nismat e studentëve, minatorëve dhe intelektualëve të popullit mbarë, u përcollën me burgosje, me shkatërrime, me dënime padrejtësisht nga pushtuesit të cilat i detyruan trimat t'i kapin armët dhe të fillojnë vetë ta mbrojnë vendin. Populli formoi Ushtrinë e tij, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e cila doli në skenë për t'i treguar botës, se ky vend ka zot shtëpie, se koha e çlirimit po vinte. Qëndresës së popullit i dha jetë edhe qëndresa historike e familjes Jashari dhe luftëtarëve të lirisë, duke i treguar botës se ky vend duhet mbrojtur, duhet ndihmuar dhe duhet çliruar. Bota bashkë me SHBA-të dhe të gjithë aleatët e saj, u rreshtuan përkrah popullit dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e çliruan vendin dhe populli filloi të frymonte me liri, tani ishim vend i lire, por i ndarë nga Shqipëria Natyrale - Shqipëria që ishte ideal i çlirimtarëve dhe ishte betimi i tyre. Ideal i mendjeve të ndritura, kombit, shpirtit dhe dëshirës së popullit, me 17 Shkurt 2008, u shpall Pavarësia e Kosovës, bota filloi të na njeh, institucionet u formuan, ndërsa tani jemi shtet demokratik para botës, synimi ynë është të rrugëtojmë në Aleancën e NATO-s, BE-në dhe në Kombet e Bashkuara, si shtet me të drejta e barabarta, si të gjithë popujt e tjerë. Tani 18 vite rrugëtim i shtetit më të ri në Evropë, i një prej popujve më të vjetër të Evropës, rrugëtimi ynë si popull dhe shtet tashmë po vazhdon në një dimension tjetër, atë të zhvillimit, përparimit dhe forcimit. Bashkëndejmë me çlirimtarët tanë të cilët po gjykohen padrejtësisht në Tribunale të padrejta, andaj urojmë që festën tjetër të pavarësisë së shtetit tone, për të cilin luftuan ata çlirimtarë që gjenden atje, ta festojmë bashkë me ta, e gëzofshim këtë ditë për jetë e mot, u kujtoft kjo datë bashkë me heronjë, dëshmorët dhe martirët. Falënderit.

Kryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë, të nderuar të pranishëm, të nderuar asambleist/e, i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës z. Vlonjat Hasani, i nderuar kryetar i parë i Komunës së Fushë-Kosovës z. Naser Grajçevci, i nderuar Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës z. Skënder Zogaj, falënderit për pjesëmarrje na keni nderuar, i nderuar Komandant i Policisë së Stacionit të Fushë-Kosovës z. Bekim Zogjani, përfaqësues të Organizatave të dala nga Lufta z. Sadik Konjusha dhe z. Xhevdet Qiriri, përfaqësues nga Këshilli i Bashkësisë Islame, i nderuar Hoxhë z. Fitim Gërguri, mirë se keni ardhë dhe urime kjo festë. Sot festojmë 18 vjetorin të shtet formimit, shtetit të cilit jeni duke i shërbyer me përkushtim dhe ndershmëri, pa e harruar asnjëherë sakrificën e brezave të kaluar, të burgosurve politikë siç ishin: z. Adem Demaçi e z. Ukshin Hoti, brezave të

ilegalitetit të periudhave të ndryshme të historisë, kujtojmë Presidentin Historik të Republikës së Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, i cili me politikën e tij, bëri që çështja e Kosovës të njihet anë e mbanë botës vendim marrëse, kujtojmë gjakun e dëshmorëve, martirëve të rënë për liri, luftën e çlirimtarëve të Kosovës në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari, luftë e cila solli lirinë të cilën e gëzojmë dhe do ta gëzojnë brezat e ardhshëm, që do të rriten në këto troje. Kujtojmë përherë akterët kryesor të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, të cilët sot gjenden padrejtësisht në Hagë - Ish/Presidenti Hashim Thaqi, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi e Kadri Veseli dhe urojmë, që sa më parë të kthehen në vendlindje, do t'i kujtojmë për motë e jetë, secilin e secilën që dhanë kontribut për çlirimin e vendit, e që numri është i madh, sepse këto troje janë larë me gjak gjatë gjithë etapave të historisë, ju jemi mirënjohës gjithë jetën dhe nga këtu e kudo në Kosovë, ju themi se shteti po zhvillohet, ushtria e policia po forcohen, ekonomia po rritet e përfaqësimi në arenën ndërkombëtare çdo vit po bëhet më dinjitoz. Sot kam nderin të ju drejtohem juve në këtë mbledhje solemne, ku në mesin tonë kemi gjenerata që kanë dhënë shumë për këtë vend, duke mos kursyer asgjë, as jetën e tyre dhanë gjithë çka për lirinë tonë, andaj urimi më i mirë është puna, angazhimi dhe përforcimi i shtetit, të cilën punë e bëjmë çdo ditë së bashku. Kam nderin që në përjashtim të rendit të ditës sot t'i ftoj për një fjalë rasti dy Ish/Kryetarët e Komunës së Fushë-Kosovës z. Naser Grajçevci dhe z. Skënder Zogaj. Gëzuar përvjetorin e 18-të, e paqim për jetë e mot, falënderit.

Naser Grajçevci: Falënderit kryetar, të nderuar të pranishëm z. Skënder Zogaj, të nderuar përfaqësues të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfaqësues të invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është kënaqësi sot të jemi bashkë këtu në këtë 18 vjetor të Pavarësisë së Kosovës, sot është festë, sot duhet të jemi të gjithë të bashkuar, të gëzojmë këtë ditë, e cila besoj që do të jetë e shënuar me shekuj dhe do të jetë e kujtuar. Nuk do e zgjas shumë meqenëse dy parafolësit i thanë të gjitha, i përkujtuan sakrificat e këtij populli me histori ndër breza dhe sot jemi gjeneratë me fatë, që gëzojmë lirinë, është derdh gjaku vazhdimisht por frytet kanë qenë të mangëta. Ne dëshirojmë dhe urojmë që një monstrum i Hagës, i krijuar padrejtësisht fatëkeqësisht nga klasa jonë politike të përfundojë në të mirë të Kosovës, të përfundojë në të mirë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në mënyrë që kjo njollë e zezë t'i shlyhet njëherë e përgjithmonë. Dhe njëherë ju uroj këtë ditë të madhe, ju uroj këtë festë dhe gëzofshum gjithmonë, falënderit.

Skender Zogaj: Nuk ka dyshim se është një nderë i veçantë për mua, sepse për mua Fushë-Kosova, paraqet pikën më të rëndësishme të planetit. Jam shumë i lumtur që ndodhem sot para jush dhe që po e nisë fjalën time me urimin më të përzemërt për Kryetarin e Komunës z. Prebreza, i cili gëzon autoritetin e qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës dhe besimin tim të plotë se ai do të jetë një udhëheqës i mirë 4 vjeçar, e nisa kështu fjalimin sepse gjithë çka e fjalëve nuk e ka asnjë vlerë nëse fjalët nuk mbulohen me vepra. Unë jam i bindur se ideali i Fushë-Kosovës, i nisur në vitin 1990, me shumicën e emrave që janë sot në këtë sallë, të cilët në kohën e rrethanave jashtëzakonisht të këqija dhe të rënda, e kanë hapur zemrën dhe shtëpiat për të cilat jemi sot këtu. Jam shumë i lumtur që sot do të kenë nga një mirënjohje, e cila është gjëja më e mirë në botë, njerëzit i besojnë Zotit përmes mirënjohje, shprehin mirënjohje, por nuk i dërgojnë dhurata tjera prandaj unë e konsideroj mirënjohjen, që sot na vjen nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, si diçka tepër të madhe, sepse kujdesi ndaj qytetarëve duhet të jetë gjithmonë i afërt dhe permanent. Naseri, Valoni dhe Vlonjati thanë atë që duhet për Pavarësinë e Kosovës, unë them që Pavarësia e Kosovës, ajo e fituara do të mbrohet, nëse ne punojmë mirë dhe drejtë dhe nëse ne gëzojmë mirë dhe drejtë, në momente të caktuara të bëhemi bashkë si jemi sot. Naser Grajçevci u gëzova shumë

që e pashë sot, ka qenë personalitet i parë me të cilin e kemi nisur luftën dhe bazamentin e Fushë-Kosovës, unë mendoj që edhe unë, edhe Naseri jemi sot të lumtur, qytetarët janë më ndryshe, janë më të kënaqur, më të zhvilluar por duhet të përpiqemi shumë, që të mos lejojmë që të ndodhin gjëra të cilat janë me pasoja shekullore. Pse jam shumë krenar me ju? Sepse në vitet e 90-ta, kur gjithë çka ka qenë e blinduar me hekur qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës kanë pasur guximin jo vetëm me e përballuar realitetin, por me dhënë gjithë çka nga vetja e tyre dhe sot me qenë se, jam këtu po e përmendi një kontribut të jashtëzakonshëm paralelisht me lëshimin e shtëpive, falënderojë nga shpirti një të ndjerë z. Sylë Gërguri, i cili për mua është hero i madh. Në momentet më kritike kur mësuesit tanë nuk kanë arritur t'i marrin as 10 euro z. Sylë Gërguri, nga fondi i tij ka ndarë 120,000.00 DM, me të cilat 1 vjet janë dhënë rrogat në Komunën e Fushë-Kosovës, prandaj ta mbyll këtë fjalim me një dëshirë të sinqertë që për z. Sylë Gërguri, Kuvendi i Komunës të përgatis një mirënjohje speciale dhe ka kemi një Akademi Solemne si kjo këtu. Falënderit shumë, urime më të mira për Pavarësinë e Kosovës, urime kryetar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Vazhdojmë me procedurën e fjalimeve sipas rendit, ftojme përfaqësuesin e Lëvizjes Vetëvendosje z. Kosovar Ademi.

Kosovar Ademi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, i nderuar Kryetar i Komunës, i nderuar Nënkrjetar i Komunës, të nderuar koleg asambleist/e, të nderuar të pranishëm të organizatave të dalura nga lufta, të nderuar përfaqësues nga policia, bashkësia islame, të nderuar të pranishëm qytetarë të Fushë-Kosovës, sot nuk jemi mbledhur thjeshtë për një datë kalendarike, sot jemi mbledhur për 17 shkurtin, ditën kur sakrificat u shëndërrua në shtet, kur amaneti i brezave u bë realitet, kur Kosova mori frymë si Republikë e Pavarur. Pavarësia e Kosovës nuk erdhi si një dhuratë, erdhi si rezultat i një rrugëtimi të gjatë, të dhimbshëm, por edhe sakrificës së popullit tonë, i rezistencës paqësore, i luftës çlirimtare dhe i mbështetjes së aleatëve tanë. Sot kur festojmë kemi edhe përgjegjësi, sepse pavarësia nuk është vetëm një shpallje, është drejtësi që funksionon, është barazi për qytetarët, është zhvillim ekonomik, është transparencë dhe llogaridhënie. Si përfaqësues i qytetarëve të Fushë-Kosovës, detyra jonë është që çdo vendim, çdo projekt dhe secilin buxhet ta orientojmë drejtë forcimit të shtetit tonë duke ju shërbyer qytetarëve. Ne duhet të jemi brezi që nuk e përdori pavarësinë për retorikë, por e forcon atë me punë konkrete, sepse shteti ndërtohet në komuna, shkolla, në institucione të cilat funksionojnë me ndershmëri. Le të jetë kjo ditë, jo vetëm festë por edhe reflektim, reflektim për ata që sakrifkuan, reflektim për përgjegjësinë, që kemi dhe zotim se Kosova, do të jetë gjithmonë më e drejtë, më e zhvilluar dhe më e fortë. Lavdi të gjithë atyre që kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës, urime 17 Shkurti të gjithëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Falënderit shumë Kosovar, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, z. Laureat Gojnovci.

Laureat Gojnovci: Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës, Kryesues i Kuvendit të Komunës, koleg, këshilltarë, Komandant i stacionit policor, përfaqësues të organizatave të dalura nga lufta, oficerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, familjar të dëshmorëve, veteran të luftës çlirimtare, përfaqësues të bashkësisë islame, shumë të nderuar qytetarë të Fushë-Kosovës, në këtë përvjetor të pavarësisë të kësaj ngjarje madhore të historisë tonë në frymën e festës dhe gëzimit, më lejoni që në emër të Lidhjes Demokratike në Fushë-Kosovë, të ju uroj të gjithëve për këtë ditë të shënuar. Le të na shërbej kjo ditë dhe datë si frymëzim, një nxitje pozitive që të punojmë më shumë e me vullnet më të mirë për vendin tonë, atdheun tonë, republikën tonë,

që të zotëroj paqja, liria dhe demokracia, vlera ideale për të cilin u angazhuam me dekada, të palëkundur përkundër shtypjes, terrorit, dhunës së luftës, është detyrë e jona që këto vlera t'i ruajmë dhe t'i përcjellim në brezat që vijnë, sepse kështu e bëjme vendin tonë një çerdhe të ëndrrave e vlerave tona të përbashkëta. Në këtë ditë dhe datë të shënuar, ne kujtojmë me mirënjohje gjithë rrugëtimin tonë kombëtar, kontributin e brezve të tërë, që në periudha të vështira mbajtën fortë, mbajtën drejtë, mbajtën mbarë gjithë ëndrrën tonë shekullore për liri, pavarësi dhe barazi mes kombeve evropiane. Sot të trimëruar, nga shpirti i të parëve tanë dhe vullneti i pa epur i popullit tonë, ne me mburrje nderojmë trimërinë dhe sakrificat e bëra për të krijuar një shtet Sovran, të lirë dhe të mbushur me premtimin e demokracisë, prandaj sot në këtë ditë madhështore, ne kujtojmë me nderim e mirënjohje lëvizjen më të madhe shqiptare të Kosovës, atë për liri, demokraci e pavarësi. Kujtojmë momentin e bashkimit të popullit tonë, rreth idealeve të palëkundura e të pathyeshme, atyre që na shtynë të ndërrojmë e të përiqemi për të drejtën tonë historike për liri e pavarësi. Sot falënderojmë të gjithë aktivistët e vullnetarët që mirëmbajtën jetën tonë institucionale gjatë viteve 90-ta, i dhanë shpirtë e nxitje lëvizjes tonë. Në mënyrë të veçantë në këtë ditë të shënuar të historisë e nderojmë me vlerësimin më të epërm, prijësin e rrugës tonë Kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe presidentin historik të vendit tonë Dr. Ibrahim Rugovën, vizioni i të cilit i artikuluar me mençuri të pa shoq, në fillim të viteve 90-ta, u bë realitet në vitin 99, kur bota u bashkua me ne dhe në vitin 2008, kur përsëri ishte me ne, ditën që shpallëm pavarësinë e shtetit tonë, për qendruat përkrah nesh përgjatë rrugëtimin tonë të deri sotshëm. Po ashtu në këtë ditë shprehi mirënjohjen tonë të thellë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, atyre burrave dhe gra që luftuan për lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë, vlerësimi dhe mirënjohja për të cilët nuk do të shuhet kurrë, në përvjetorin e ardhshëm të pavarësisë së Kosovës, le ta festojmë së bashku me shpresën që pranë nesh t'i kemi dhe kërret e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që po gjykohen në Hagë. Në këtë ditë kujtojmë me mirënjohje e nderim sakrificën e Jasharajve, flijimi i të cilëve ishte Kushtrim për çlirimin tonë përfundimtar, nderojmë të gjithë ata që u flijuan në altarin e pavarësisë së Kosovës, dëshmorët, viktimat e pafajshme të luftës, emrat e të cilëve janë gdhendur me shkronjat më të bukura e të pa shlyeshme në historinë e vendit tonë. Republika e Kosovës, u bë shtet i pavarur falë unitetit tonë të brendshëm, lëvizjes paqësore, luftës çlirimtare si dhe mbështetjes ushtarake dhe diplomatike nga jashtë, u bë sepse treguam e dëshmuam dhe treguam kulturë të brendshme politike, dhamë të gjithë potencialin tonë kombëtar dhe krijuam ura bashkëpunimi mes vete dhe më larg, prandaj kaluam sfida të pa kalueshme më parë, në këtë ditë 17 Shkurtit, ndej detyrim dhe mirënjohje për të gjithë aleatët e tanë nga e gjithë bota, e në veçanti të gjitha shteteve të Aleancës veri atlantike të kryesuar nga SHBA-ja, BE-ja, që në orët më të vështira u gjetën pranë nesh, shtëpia nuk mbahet pa miq, nuk mbahej dje, nuk mbahet sot dhe nuk do të mbahet as nesër. Si gjeneratë e re politike, kemi obligim, jo si borxh detyrimi, por si sjellje fisnike e besim që këto aleanca të u mësojmë brezave që vijnë, sepse kështu na mësuam prijësit tanë si mësues të mirë që ishin. Le të punojmë së bashku për Kosovën, të qëndrojmë bashkarisht, Kosova në këto dekada të lirisë e pavarësisë ka shënuar progresin më të madh të saj, në historinë disa shekullore, progres të cilin e kemi për detyrë ta ruajmë dhe ta dërgojmë më tutje. Rezultatet që kemi arritur duhet të shërbejnë si rrugë ndriçuese që të këndellemi e të ecim të bashkuar drejtë të ardhmes, duke mos kërkuar barriera në çdo mundësi, por duke punuar në frymën e tolerancës, mirëbesimit e vullnetit të mirë. E shkuara jonë është e lavdishme dhe e pa përsëritshme, mbi të gjitha është e pa arritshme dhe e pa ndryshueshme, e ardhmja jonë është e pa definuar, është e

pashkruar dhe aty sot kemi rol ne, aty përcaktojmë kujtimin e njerëzve tjerë, në këtë të ardhme ne përcaktojmë kujtimet tona si shoqëri në rrugëtimin origjinal për NATO dhe BE, këtë rrugë duhet ta bëjmë ne si testament për gjeneratat, që vijnë dhe si mirënjohje për ato që s'janë më. Rrugëtimi ynë si shtet krenar me njerëz të jashtëzakonshëm, të ardhme të ndritshme do të vazhdojë, sepse ky rrugëtim nuk ka kthim prapa sepse Kosova, atdheu ynë është i përherëshëm, sepse Republika është e përherëshme dhe e pavdekshme. Zoti e bekoft Kosovën tonë të bukur, njerëzit e saj punëtorë, e të devotshëm, miqët tanë dhe aleatët e palëkundur, Zoti e bekoft këtë ditë, faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë Laureat, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Migjen Kolshi.

Migjen Kolshi: Të nderuar qytetarë të Komunës së Fushë-Kosovës, të nderuar familje të dëshmorëve, të nderuar përfaqësues të organizatave të dalura nga lufta, i nderuar kryetar z. Prebreza, i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës z. Hasani, të nderuar të pranishëm sot nuk jemi mbledhur vetëm për të shënuar një datë, sot jemi mbledhur për të kujtuar një amanet, përkulemi me nderim të thellë para sakrificave të brezave që ëndërruan lirinë, kur ajo dukej e pamundur, që besuan në shtet kur ai ishte vetëm shpresë në zemrën e tyre. Pavarësia jonë nuk erdhi si dhuratë ose marrëveshje, ajo u pagua me gjakun e bijëve dhe bijave tona të vendit, u shkrua me shumë dhimbje, lot nënash, me netë pa gjumë dhe me plagë që ende nuk janë të mbyllura. Sot kur flamuri ynë valvitë i lirë, ne përkujtojmë me përlulësi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, familjet e tyre që jetojnë ende me dhimbje, martirët e luftës dhe invalidët e luftës, ata nuk kërkuan lavdi, kërkuan vetëm liri. Liria që gëzojmë sot, nuk është vetëm liri, është zëri ynë, që flet pa frikë, është flamuri që ngreh me krenari, është buzëqeshja e një fëmije që rritet me shkronjat e alfabetit tanë, është e drejtë të themi jemi shqiptarë dhe jemi të lirë. Sot me zemër të rënduar dhe besim të palëkundur kujtojmë ata që përballen me drejtësinë në Hagë, presidentin Hashim Thaqi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, emrat e tyre janë të lidhur me një kapitull të rëndësishëm të historisë tonë, ne besojmë në drejtësi, besojmë në të vërtetën dhe presim me durim e dinjitet ditën kur ata të triumfojnë. Liria jonë nuk është vetëm një emocion, ajo është histori sakrificë e përkushtim dhe për ne liria ka emër, ka emrin e atyre që guxuan kur të tjerët heshtën, ka emrin e atyre që sakrifikuuan kur të tjerët u nënshtruan, ka emrin e atyre që deshën Kosovën më shumë se vetën. Të nderuar/a të pranishëm Fushë-Kosova, ka qenë dhe mbetet një simbol i qëndrësës dhe sakrificës tonë, në periudhat më të vështira të historisë tonë qytetarët e kësaj komune dëshmuuan se, dinjiteti nuk dorëzohet dhe se liria kërkon përkushtim, kështu dhimbja u shëndrrua në forcë, sfidat, vendosmëria e sakrificat janë gurë themelet e shtetësisë sonë, sot përkujtojmë dhe festojmë, ne nuk nderojmë vetëm një datë historike, ne nderojmë rrugëtimin e mundshëm drejtë lirisë, kontributin e familjeve të dëshmorëve, të zhdukurve, invalidëve të luftës dhe gjithë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, prandaj le ta duam Fushë-Kosovën dhe Republikën tone, jo vetëm me ndjenja por edhe me veprime konkrete. Qoftë e përjetshme liria e Kosovës, lavdi dëshmorëve, urime të gjithëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë Migjen, në emër të Organizatave të dalura nga Lufta z. Sadik Konjusha.

Sadik Konjusha: Të nderuar të pranishëm, i nderuar Kryetar i Komunës, i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, i nderuar Komandant, të nderuar përfaqësues të institucioneve, të nderuar përfaqësues politikë, të nderuar të pranishëm, familje të dëshmorëve dhe martirëve, bashkëlufetarë, qytetarë të Fushë-Kosovës, sot në këtë ditë madhështore për kombin tonë,

shënojmë me krenari Pavarësinë e Republikës së Kosovës, arritjen më të madhe të historisë tonë moderne. Tani 17 Shkurti është dita kur u vulos përfundimisht sakrificat e një populli, që nuk pranoi robërinë, që nuk u gjunjëzua dhe që luftoi për të jetuar i lirë në tokën e vet. Pavarësia e Kosovës, nuk erdhi si dhuratë nga askush, ajo erdhi si rezultat i një çmimi të shtrenjët, gjakë, mund, lot dhe sakrificë. Në themel të kësaj lirie qëndron Ushtria Çlirimtare e Kosovës, lufta më e drejtë që ka njohur bota. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte zëri i popullit të shtypur, ishte përgjigja e dinjitetshme ndaj gjenocidit dhe dhunës, ishte shpresa e Kosovës, për mbijetesë. Si përfaqësues i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, në Komunën e Fushë-Kosovës, sot ndjej obligim të flas jo vetëm për festë, por edhe për një plagë që ende na dhemb, sepse është e rëndë dhe e padrejtë që ne ditën kur ne festojmë lirinë, udhëheqësit e luftës çlirimtare dhe të shpalljes së pavarësisë përfshirë ish/presidentin Hashim Thaqi, ndodhen në Tribunalin e Hagës, të akuzuar padrejtësisht për krime lufte. Kjo është një padrejtësi historike, ne e dimë kush është agresori dhe kush ishte viktima, ne e dimë kush vrau, dogji e masakroi dhe ne e dimë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës, nuk ishte ushtëri pushtuese por ushtëri çlirimtare, nuk mund të barazohet lufta për liri me krimet që i ka bërë pushtuesi jonë shekullor. Lufta jonë ishte e drejtë dhe e domosdoshme, Kosova sot është e lirë sepse dikush pati guxim të marrë përgjegjësi, sepse dikush udhëhoqi rrugën drejtë shtetit. Sot në këtë ditë feste kërkojmë drejtësi të vërtetë, jo drejtësi të njëanëshme, kërkojmë që historia të mos shtrembërohet, është përgjegjësi e secilit prej nesh që këtë shtet ta ndërtojmë me punë, arsim, me drejtësi dhe unitet. Le ta festojmë këtë ditë me krenari por edhe me përkushtim për të ardhmën që brezat që vijnë të jetojnë në një Kosovë gjithënjë e më të fortë, më të zhvilluar dhe më të respektuar. Urime pavarësia deri në bashkim, lavdi dëshmorëve të kombit.

Kryesuesi i kuvendit komunal: Faleminderit shumë z.Konjusha, siç e paralajmëruam në fillim kjo pikë e rendit të ditës mbyllet me kaq, për tu shkëputur për 5 minuta, për shkak të programit artistik që është paraparë nga krejt udhëheqësit e kësaj ceremonie për të vazhduar më pas me pikën e dytë të rendit të ditës që është ndarja e mirënjohjeve nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Kryetari i Komunës për familjet të cilat kanë kontribuar në shtëpi-shkolla gjatë viteve të 90-ta, në Komunën e Fushë Kosovës, atëherë le të vazhdojmë me pikën tjetër për tu shkëputur për pak nga seanca. Faleminderit.

Rinesa Simnica: I nderuar Kryesues i Kuvendit, Kryetar Komune, ish Kryetar Komune, asambleist/e, përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta ju faleminderit shumë për të gjitha këto fjalime frymëzuese. Shfrytëzoj rastin të falenderoj publikisht Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Ylber Kelmendi, i cili së bashku me stafin e tij ka përfeksionuar çdo detaj të këtij event, i nderuar drejtor dhe staf faleminderit shumë. Përveç festës së pavarësisë sot jemi mbeldhur këtu për të nderuar një vepër të madhe, të heshtur por jashtëzakonisht të fuqishme e cila është sakrificat dhe guximi i atyre që në kohërat më të vështira për vendin tonë hapën dyert e shtëpive të tyre për të mbajtur gjallë dritën e dijes. Në periudhën më të errët të kombit shqiptar kur shkollat u mbyllën padrejtësisht dhe arsimit shqip u rrezikua, ishin shtëpitë e juaja ato që u kthyen në klasa, ishin oborret tuaja që u kthyen në vend shprese dhe ishin zemrat tuaja ato që u bënë mburoj dhe strehë për të ardhmen e këtij vendi, në ato mure të thjeshta shtëpish u rritën ëndrra, u formuan breza e sot me respekt e mirënjohje të thellë e nderojmë këtë kontribut të çmuar i cili ishte më shumë se veprim human, ishte vepër e madhe patriotike, ju faleminderit shumë. Në shenjë respekti dhe falemnderimi institucional për këtë kontribut të çmuar jam e lumtur që krahe meje kam Kryesuesin e Kuvendit të Komunës z.Vlonjat Hasani, si dhe Kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës z.Valon Prebreza, për

të ndarë mirënjohjet për familjet që në kohën më të vështirë hapën dyert e shtëpive të tyre për arsimin shqip. Atëherë po fillojmë me shpërndarjen e mirënjohjeve, ku prezentë janë familjarët e prindërve të tyre që kanë lëshuar shtëpitë e tyre për zhvillimin e procesit edukativo-arsimorë dhe vetë personat që e kanë dhënë një kontribut të tillë, e lus Idealin që të vij pranë meje për t'i ftuar të gjithë të pranishmit dhe familjarët e atyre që lëshuan shtëpitë e tyre.

1. Xheladin Zagragja, nuk është prezentë
2. Hasan Raqi
3. Nasuf Grajçevci
4. Qazim Imeri
5. Salih Slivova
6. Ali Dumani
7. Hamëz Zogjani
8. Qazim Sollova
9. Shyqeri Berisha
10. Shaban Xhigoli
11. Haki Xhigoli
12. Ragip Grajçevci
13. Haxhi Grajçevci
14. Mustaf Grajçevci
15. Isa Grajçevci
16. Ramë Miftari, nuk është prezentë
17. Rizah Pllana
18. Nazmi Tërmkolli
19. Shyqeri Sllamniku, nuk është prezentë
20. Ragip Qyqalla
21. Avdi Avdiu
22. Ismail Beka, nuk është prezentë
23. Bislim Bajçinca
24. Feriz Bobaj
25. Avdyl Kutllovci
26. Ahmet Merovci
27. Nazif Pireva
28. Limon Drenovci
29. Hysen Dumani
30. Halit Kelmendi
31. Hilmi Toçani
32. Hamit Kelmendi
33. Bajram Jashanica
34. Fehmi Jasharaj
35. Avdi Breznica
36. Azem Grajçevci
37. Adem Shala

38. Shefqet Tërmkolli
39. Emin Kabashi
40. Muharrem Budeci
41. Bajram Gjyrevci
42. Fejz Jashari
43. Rrahim Berjani
44. Nazmi Osmani
45. Ramadan Dragusha
46. Rexhep Bullatovci
47. Bajram Ajeti
48. Kadri Mekolli
49. Hamdi Avdiu
50. Xhevat Mjeku
51. Isuf Kostanica
52. Rexhep Kostanica
53. Adem Zogjani
54. Avdyl Gërguri
55. Resul Hyseni
56. Bajram Gashi
57. Elmi Malaj
58. Sejdi Gashi
59. Ukë Hyseni
60. Hashim Islami
61. Islam Berisha
62. Fejzullah Beha
63. Xheladin Zogjani
64. Ismet Baca
65. Isuf Zogaj
66. Jakup Grajçevci
67. Mustaf Prebreza
68. Isak Berisha
69. Shaqir Konjusha
70. Fehmi Xhigoli
71. Sherif Grajçevci
72. Hetem Grajçevci
73. Jeton Beka
74. Zeqir Mjeku
75. Islam Zogjani
76. Qemail Sllamniku
77. Nebih Bajçinca
78. Abdurrahman Dervisholli
79. Naim Gojnovci
80. Behxhet Zogjani

81. Avdi Kelmendi
82. Agim Mjekiqi
83. Isuf Krasniqi
84. Hamdi Shala
85. Abaz Kodra
86. Hamit Gojnovci
87. Rizah Bajçinca
88. Zenel Halimi
89. Shahin Idrizi
90. Mehdi Tërmkolli
91. Ismet Zeqiri
92. Zejnullah Halimi
93. Sylejman Zogaj
94. Ramë Zeka
95. Islam Shala
96. Xhafer Shala
97. Ajet Haziri
98. Nezir Konjuhi
99. Sejdi Obërtinca
100. [Zenel Hyseni](#)
101. Ibrahim Sejdiu
102. Ramadan Berisha
103. Naim Zogaj
104. Shemsedin Zogaj
105. Ramë Veseli
106. Habib Bytyçi
107. Jakup Bullatovci
108. Agim Krasniqi
109. Milaim Maliqi
110. Mustafë Rushiti
111. Sejdi Osmani
112. Shefki Tërnavë
113. Kadri Simnica
114. Islam Islami
115. Azem Sogojeva
116. Hanife Mexhuani
117. Rizah Grajçevci
118. Ali Rushiti
119. Rizah Qyqalla
120. Ilaz Gërguri
121. Faik Uka
122. Hamdi Pirraku
123. Idriz Krasniqi

124. Nazmi Zogjani
125. Mustafë Konjusha
126. Zekë Rrecaj
127. Rizah Gashi
128. Hilmi Krasniqi
129. Rrahim Bajçinca, nuk është prezentë.
130. Islam Gërguri
131. Raif Jashanica
132. Fazli Jashanica
133. Ramush Breznica
134. Mehdi Xhigoli
135. Pajazit Islami
136. Hysen Sogojeva
137. Manush Shurreci
138. Muharrem Jashanica
139. Muharrem Orllati
140. Bajram Gashi
141. Rexhep Kostanica
142. Isa Tërnavë
143. Faik Grajçevci
144. Habib Obërtinca
145. Shaban Kostanica
146. Amërllah Maxhuni
147. Hamdi Grajçevci
148. Jusuf Hykaj
149. Salih Shabani
150. Mehmet Krasniqi
151. Mustaf Bajçinca
152. Ibrahim Berisha
153. Ramdush Gojnovci
154. Avni Zogjani
155. Llukman Gjata
156. Azem Berisha
157. Jakup Tërnavë
158. Selim Islami
159. Hetem Tërnavë
160. Hashim Zogjani
161. Latif Berisha
162. Ferat Gashi
163. Sabit Reqica
164. Ismet Bajçinca.
165. Ramadan Gërguri
166. Xhemë Breznica

167. Mustaf Jashanica
168. Hajzer Bajçinca
169. Sahit Tërnavë.
170. Bejtush Krasniqi
171. Bislim Zogaj
172. Skënder Zogaj
173. Ajet Ajeti
174. Sabit Lugolli
175. Shaip Kelmendi
176. Azem Syla
177. Asllan Statovci
178. Ismet Avdiu
179. Shaban Qyqalla
180. Fazli Bytyçi.
181. Hamëz Hoti
182. Beqir Kelmendi
183. Agim Kelmendi
184. Bekim Morina

Rinesa Simnica: Kaq kishim sa i përket mirënjohjeve, ata që kishin mirënjohje, por nuk ishin prezentë do i marrin pastaj. Të nderuar të pranishëm kjo ngjarje nuk do të ishte kaq e bukur pa pranin tuaj, kështu që unë ju falënderoj shumë, por për ta përmbyllur këtë event në mënyrën më të mirë të mundshme, unë kam kënaqësinë ta ftojë nxënësen e Gjimnazit 'Hivzi Sulejmani', Elisa Kajtazi për një monolog i cili quhet 'Himni i Jetës'.

Elisa Kajtazi - Prezantimi i Monologu: A i dëgjon zërat e dritës kur shkrepnin agimi vetë, e jeta qenka si fëmija jepi dorën që ta ngresh, që të vij jeta me ty nëpër diell edhe furtunë, mirë atëherë mbille një pikë djerse, mbille në një kokërr grurë, mbille në një gërmë, a në një shkronjë, mu në zemër të një fjale mbille, mbille zërave të lehtë të prillit, ardhjes së dimrit nëpër male, mbille në duart të një plaku, nëpër buzët e një fëmie, mbille në pikën e gjakut jetën, që të vijë jeta me ty siç vjen shoku i vërtetë. Mirë, atëherë shko drejtë saj bëhu shok i jetës t'i vet, ndizi diejt, ndizi qiejt, qiell edhe diell trupin tënd, romantikat e përgjakura kapi mbërthej me dhëmbë, si kotelet që i mer nëna dhe i qon nga një ditë në tjetrën mes përlëshjeve njerëzore, ashtu edhe t'i mbërtheje jetën. Dashurin rrëmbe dhe ëndrrat, rrugëtimi i kohës nuk ndalet edhe vetë në fjalën vdekje mbille dhe jeta do të ngjallet. Ai dëgjon zërat e dritës, shkrepnin agimi vetë e jeta qenka si fëmija të shikon në sy edhe qesh.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Falënderit të gjithëve për durimin, vëmendjen dhe bashkëpunimin që patët deri më tani. Zyrtarisht po e mbyllim mbledhjen solemne të sotme, duke ju uruar edhe njëherë Ditën e Pavarësisë dhe vazhdojmë me aktivitete të tjera.

Fushë-Kosovë 17 Shkurt 2026

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

